



Tifozet e Tiranës kanë nisur të kërkojnë dy ish lojtarëve bardheblu të rikthehen. Ilion Lika dhe Erion Dushku prej disa kohësh po marrin mesazhe nga bardheblutë që i kërkojnë të jenë sërish pjesë e Tiranës. Skuadra e kryeqytetit po kalon një moment mjaft të vështirë dhe tifozet e kanë kuptuar se largimi i dy lojtarëve në sezonin e kaluar ka qenë i gabuar dhe se me largimin e tyre u prish boshti që mbante ekipin. Tani që po rihapet merkato, drejtuesit e Tiranës i kanë kontaktuar këta dy lojtarë ndërsa edhe tifozet nuk po rrinë duarkryq duke kërkuar me ngulm rikthimin e tyre.